

# MBI GJËNDJEN DHE PERSPEKTIVËN E STUDIMEVE MJEDOLOGJIKE

**Mentor QUKU**

E-mail: [mentorquku@yahoo.co](mailto:mentorquku@yahoo.co)

## 1. Hyrje

U deshën të kalonin 70 vjet nga vdekja e magjistarit të tingujve të gjuhës shqipe, Dom Ndre Mjedës, që më në fund të organizohej një veprimtari shkencore me karakter solemn, kush-tuar veprës letrare dhe gjuhësore të tij. Kjo është sa optimiste aq edhe tragjike. Para 20 vjetëve, Idriz Ajeti, në fjalën përmbyllëse të Seminarit XII ndërkom-bëtar për gjuhën, letërsinë dhe kultu-rën shqiptare, (1986, Prishtinë) nënvi-zonte i dëshpëruar se *vepra letrare dhe gjuhësore e Ndre Mjedës u vështrua nga disa anë të saj, por jo sa e donte puna dhe sa e meritonte kjo figurë e shquar e kulturës shqiptare*. Më pas u bënë edhe tre veprimtari të tjera, kushtuar Mjedës, por që nuk e ndryshuan gjëndjen e përgjith-shme, njera në New York (1987), tje-tra në Shkodër (1996) dhe së fundi në Napoli (2001). Të tëra këto veprimtari patën vlerat e veta, por nuk arritën të tërhiqnin mendimin shkencor në masën që e meritonte jeta dhe vepra e Mjedës. Emri i Mjedës ishte i lidhur sa me një neglizhencë aq edhe me një in-teresim të madh, sa me debate aq edhe

me thashetheme, sa me dishepuj aq edhe me kundërshtarë: Kemi të bëjmë me një Shqiptar të Madh që zotëronte energji të pashterrshme, që tërë jetën luftoi për lirinë e tij, për lirinë e atdheut, si dhe për lirinë e tërë njerëzve të globit. Kemi të bëjmë me një artist gjenial, me një shkencëtar të përmasave botërore, i cili tejkaloi shekullin e vet, i cili nuk arriti ta kuptonte.

## 2. Niveli i sotëm i studimeve mjedologjike

Mjeda është një nga personalitetet më të lexuara, më të studiuara dhe më të debatura në historinë e gjuhë-sisë, letërsisë dhe kulturës shqiptare. Tashmë mund të flitet lirshëm për ekzistencën e një disipline shkencore më vete, *Mjedologjinë*, e cila është ndërtuar mbi qëllime, objektiva dhe ligje të qarta që veprojnë në mënyrë aktive në studimet mbi Mjedën. *Jeta dhe vepra e Ndre Mjedës*, mbetet ndër temat më të klikuara në internet, ndër temat më të botuara e më të lexuara. Ajo mbetet objekti i plotë i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për *Mjedologjinë*.

Mjeda ishte produkt i kohës së vet, por që e tejkaloi atë në shumë drejtime. Si e tillë, *Mjedologjia*, si disiplinë shkencore, mban lidhje me shkencat mëmë, si *Historia e Shqipërisë*, *Historia e Albanologjisë*, *Historia e Letërsisë shqipe*, *Historia e Gjuhësisë shqiptare*. Po ashtu me shkencat e rëndësishme si *Mitologjia*, *Demonologjia*, *Hagjiografia*, *Patrologjia*, *Sociologjia*, *Politologjia*, *Estetika*, *Teologjia*, *Filozofia*, *Bibliografia*, *Kaligrafia*, *Ortoepia*, *Ortografia*, etj. Besoj se në një të ardhme të afërme në fakultetet shqiptare do të studiohet si shkencë më vete. Ajo do të përbëjë një degë të rëndësishme të programeve kualifikuese të albanologëve të rinj.

Si çdo shkencë edhe *Mjedologjia* përjeton fillimet e veta, ndërkohë që pret të kultivohet e thellohet më tej. Po skaliten të vërtetat e mëdha që lidhen me jetën dhe veprën e Mjedës, janë ato që nuk kanë nevojë për t'u vërtetuar. Siç ishte Mjeda një shumë kontradiktash të brendshme, edhe studimet mjedologjike janë një pasqyrë e tyre: në disa segmente këto studime kanë mbetur prapa, në nivele fillestare apo në gjendje latente. Studiues me emër të kohës, si Justin Rrota, Injac Zamputi, Dhimitër Shuteriqi, Jup Kastrati, Vehbi Bala, Mark Gurakuqi, Mark Ndoja, Rinush Idrizi, Llazar Siliqi, Robert Shëanke, Qemal Draçini, Jolanda Kodra kanë bërë gjëra shumë të bukura në fushë të studimeve mjedologjike. Ata janë pararendësit e kësaj disipline shkencore. Është

meritë e tyre që sot është përvijuar dimension i shumëplanësh i Mjedës, profili i tij si klerik i devotshëm, atdhetarizmi i tij i flaktë, vokacioni i tij si lirik modern, misioni i tij si politikan i vendosur i çështjes kombëtare, angazhimi i tij si luftëtar i paepur i lirisë. Poet i ndjesive të veçanta, ndjekës i shkollës klasike, me gjendje romantike, i ndikuar nga kontakti me rrymat simboliste, moderniste, dekadente, Mjeda është novator i poezisë shqipe, një ndër majat olimpike të saj. Por po aq i shquar paraqitet në prozën shqipe, duke i dhënë letërsisë shqiptare perla të vërteta. Por qe edhe muzikolog, muzikant, piktor, skulptor, arkitekt, estet, kritik i zoti. Qe një artist në kuptimin e vërtetë të fjalës, ndoshta ndër të paktët, vepra e të cilit do të përballojë shtrëngatat e kohës. *Mjedologjia* po merr një hov të paparë, provë e sa cilës është edhe suksesi i mbajtjes së kësaj konference. Fondet arkivore e bibliotekare të hapura japin mundësira të mëdha për zhvillimin e *Mjedologjisë*.

Por në përgjithësi studiuesit e deritanishëm janë marrë edhe me shumë tema të tjera, përveç asaj të Mjedës, kështu që krahas kontributeve të tyre të vyera, studimet e tyre, shpesh kanë mbetur në sipërfaqe, në rajone të kufizuara tematike, apo të shkëputura nga njera-tjetra. Kanë munguar studimet e specializuara. Censura, autocensura, retushimet dhe kufizimet e kohës kanë bërë punën e tyre

kufizuese. Studimet mjedologjike e kanë pësuar shpesh herë nga emocionet negative, duke kaluar në betejën e fjalëve. Ka munguar mendimi kritik, e sidomos kritika e specializuar në fushë të *Mjedologjisë*. Kanë munguar projekte serioze nga institutet shkencore zyrtare.

### 3. Perspektivat e studimeve mjedologjike

Zhvillimet e *Mjedologjisë* kanë nxjerrë në pah një gamë të pafund problemesh që lidhen me jetën dhe veprën e Mjedës:

**Fëmijëria e Mjedës në atdhe:** Jeta e Mjedës është plot paradokse, plot enigma, plot kontradikta, gjë që ka sjellë vështirësi serioze për studiuesit e tij. Vështirësitë më të mëdha i takojnë periudhës së fëmijërisë, që e kaloi në vendlindje, si dhe asaj të rinisë që e kaloi me studime jashtë shtetit. Periudha e fëmijërisë dhe e adoleshencës e kaluar në qytetin e lindjes, në Shkodër, si dhe në fshatrat rrethe-qark, mbetet një nga pjesët më të panjohura të jetës së tij. Pavarësisht studimeve të shumta, kjo periudhë ka mbetur mjaft e paqartë. Kanë munguar informacioni dhe burimet dokumentare. Kjo ka ndodhur për shkak se prindërit e tij ishin njerëz të thjeshtë nga populli, pa një biografi publike, e cila nuk mungon për personalitete të tjera shkodrane të nivelit përfaqësues. Është e vërtetë se ylli i vëllezërve Mjeda u ngjith shumë shpejt në apo-

gjeun e qiellit shqiptar, por pikërisht ky fakt shkaktoi një valë refraksioni në popullsinë qytetare konservatore shkodrane, të cilët në ndryshim nga të huajt, i pranuan ata me rezerva.

**Problemi i rinisë dhe i studimeve jashtë shtetit:** Problemi tjetër i rëndësishëm që pret të sqarohet është periudha e studimeve të tij në seminarët jezuite, që përmyllet me largimin dhe kthimin në atdhe. Mbeten për t'u bërë gjurmime të hollësishme në arkivat, kryesisht në Arkivin e Propoganda Fides, Arkivin e Jezuitëve, Arkivin Sekret të Vatikanit, në Arkivin Historik të provincës Veneto në Gallarate. Duhet gjurmuar në Krakovë, Kraljevica, Francë, Spanjë, Cremona, Gorizia, Stamboll, Romë. Por kjo nuk përjashton kërkimet që duhet të vazhdojnë në AQSH, apo arkivat, muzeumet apo bibliotekat shqiptare, qoftë edhe në arkivat e bibliotekat personale.

**Dorëshkrimet autografe të Mjedës:** Një ndër fushat më të hapura, ku mund të nxiten sidomos mjedologët e rinj, ku kërkohen programe e projekte të kualifikuara e të specializuara, është ajo e kërkimeve të dorëshkrimeve autografe të Mjedës. Duke patur parasysh se Mjeda ishte një punëtor i palodhur që punoi shumë gjatë tërë jetës së tij, mendojmë se dorëshkrimet autografe që kemi sot në dispozicion prej tij e që nuk janë të pakta, megj-

thate zënë një përqindje të vogël të sasisë së përgjithshme të atyre që duhet të ekzistojnë në të vërtetë. Por duhen kërkuar, duhen gjetur, duhen identifikuar, duhen transkriptuar dhe komentuar me akribi shkencore. Mbetet që të zbulohen dorëshkrimet e veprave të tij të njohura, po ashtu edhe variantet e shumta të dorëshkrimeve të përpunimeve të poezive të tij. Po ashtu dorëshkrimet e studimeve apo të përkthimeve të veprave hagiografike e në përgjithësi atyre konfesionale. Mbeten objekt kërkimesh dorëshkrimet e transkriptimit të autorëve tanë të vjetër, si Bogdani, Budi, apo të tjerët. Supozohet që mbeten akoma të sapo zbuluara dorëshkrimet e veprimtarisë së tij të dëndur politike në parlamentin shqiptar në vitet 1921-1924, në grupin *Ora e maleve*. Kryesisht duhet kërkuar në fondet e parlamentit që ruhen në AQSH.

Pastaj vijnë dorëshkrimet e studimeve të tij me karakter gjuhësor e lingvistik. Duhet kërkuar dorëshkrimet e veprave të tij të panjohura si *Miku Bestar*, *E Diela në Kishë të katundeve*, *Kalendari i shoqnisë Dija 1906*. Mendojmë se duhen kërkuar e bërë studime lidhur me vepra që dihet se ai i ka patur në dorë po që nuk dihet se ku kanë përfunduar, si *Fjalori etimologjik*, *Fjalori i gjuhës shqipe*, si dhe atyre që njihen si *Juvenilia 1917*, *Vërejtje për artikuj e premna prones të gjuhes shqipe(1934)*. Duhet bërë kërkime edhe për autografet që ka dhënë Në këtë

fushë studimi i specializuar i kaligrafisë së Mjedës mbetet detyrë parësore për mjedologët e rinj sepse pjesa më e madhe e veprës së Mjedës është e shpërndarë, e falur ose anonime. Mbetet një objekt studimi praktika drejtshkrimore e Mjedës dhe evolimi i saj në periudha të ndryshme të jetës së tij. Duhet që të kemi parasysh se pavarësisht teorive të tij novatore në gjuhësi, Mjeda nuk i përdori ato në drejtshkrimin e tij, sepse kishte bindjen se ato, duhen pranuar prej të gjithëve më parë, pastaj të praktikohen nga ai.

**Letërkëmbimi i Mjedës:** Dom Ndre Mjeda që në moshë të re hyri në lidhje me albanologët më të mëdhenj të kohës si Gustav Meyer, Holger Pedersen, Carlo Brugmann, Patch, Jagiç, Norbert Jokli, Siebertz, Nachtigal, Tagliavini, Ippen, Zambaur, Rappaport, dhe u përpoq të hynte në lidhje me figurat më eminente të Rilindjes Kombëtare, si Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jani Vreto, De Rada, Faik Konica, Nikolla Naço, po ashtu edhe me figurat më të larta të hierarkisë kishtarë, si Miecslao Ledohovskin, Vladimir Ledohovskin, Jungun, Pasin, Abatin Doçi, Viezzolin, Della Pjetrën, Ernesto Cozzin, etj. Pati marrëdhënie me valiun e Shkodrës, me Ministrin e jashtëm te AH, Golluhovskin. Po ashtu me figura të shquara si Gjergj Fishta, Nikolla Kaçorri, Shtjefën Gjeçovin,

Pashk Bardhin, Justin Rrotën, Ndue Paluçën, Gjergj Pekmezini, Gjergj Qiriazin, Kolë Rrotën. La mbrapa dishepuj si Nikoll Gazullin, Ndue Doçin, Mark Hasin, Injac Zamputin, Giacomo Gardinin, Zef Oroshin, etj. Jeta e tij e ndërlikuar politike bëri të kishte lidhje me figurat më të shquara të kohës të botës shqiptare, si Ahmet Zogun, Musa Jukën, Fan Nolin, Luigj Gurakuqin.

Pikërisht këto marrëdhënie të shumta ngrejne si një problem problem mjaft të mprehtë përpara studimeve mjedologjike, gjurmimin e *letërkëmbimit të Mjedës*. Të dhënat që dalin nga letërkëmbimi i tij janë të një rëndësie të veçantë sepse shprehin situata dhe përjetime të brëndshme, japin njoftime për plane dhe projekte të rëndësishme me një sasi të madhe informacionesh, më të madhe se ato që rrjedhin nga relacione e dokumentacione zyrtare, të cilat duhen marrë me rezerva. Ne njohim vetëm letërkëmbimet e Mjedës me Meyerin, ndonjë segment të letërkëmbimit me Nikolla Naçon, me Lazër Mjedën, me Jakë Gardinin, me Ndre Zadejen, me ministrin e brendshëm Musa Jukën. Por kemi të dhëna të sigurta të ekzistencës së letërkëmbimit të Mjedës me Joklin, Jagiçin, Pedersenin, Nachtigalin, Bruggmannin, Paul Siebertzin, etj.

**Zbulimi dhe identifikimi i veprës së Mjedës:** Mbetet problemi më madhor i studimeve mjedologjike. Bëhet

fjalë për zbulimin dhe vlerësimin e veprës së tij albanologjike, zbulimin e ndihmesës së tij si përkthyes, si estet, si eseist, si bujk e mekanik bujqësor, si ekonomist i ekonomisë kapitaliste shqiptare, si sociolog e ambientalist, që bëri përpjekje e eksperimente për të transformuar fshatin shqiptar. Mbeten detyra parësore përpjekjet për kontributet e Mjedës në letërsinë shqiptare për fëmijë (autorësia Mjeda-Xanoni), problemi i *Gramatikës krahasuese, Fjalorit etimologjik, Fjalorit të gjuhës shqipe, Komentarit të letrave, Paraqitje e krahasuar e alfabetëve të shqipes*, bashkëpunimi me revistat *Elçia* apo *Albania*, përkthimi i tragjedisë *Sauli* të Alfierit, e të sa e sa kontributeve të tjera të tij në fusha të ndryshme të dijes. Kërkime intensive duhen bërë lidhur me prozën e Mjedës, me problemet e metodës krijuese apo lidhur me periodizimin e veprës poetike të tij. I një rëndësie të veçantë duhet të konsiderohet problemi i pseudonimeve të Mjedës, apo ai i veprave të tij anonime. Mjeda mbetet ndër mbledhësit e përpunuesit më të hershëm të folklorit e mitologjisë vendase. Në *Shahiri*, ai botoi një nga variantet më të hershme të kangës popullore të Mahmut pashës. Në periodikun *Studime Shqiptare VI*, të Meyerit, që u botua nga Akademia e Shkencave e Vjenës, në vitin 1897, Mjeda botoi fjalë të urta shqipe, këngë lirike shqipe, këngë trimërie, kryesisht nga Shqipëria e Veriut, si dhe legjenda mirditore. Duhet

parë raporti i folklorit dhe i mitologjisë vendase me krijimtarinë e tij poetike, si dhe vendi që zënë ato tek poemthat me tingllime *Scodra* e *Lissus*.

**Kontributet mbi alfabetin e përbashkët dhe normën letrare të gjuhës shqipe:** Mbetet ndofta problemi më delikat e më i nxehtë për t'u trajtuar, sepse është më i ngarkuari me emicione negative të bartura nga thellësitë e kohës.

A) *Puna e Mjedës për alfabetin e përbashkët gjatë viteve 1887-1914.* Këtu përfshihen problemet e fillimeve të punës së Mjedës me alfabetin e shqipes në periudhën 1887-1898, për të vazhduar me ato që lindën sapo Mjeda erdhi në Shkodër në krye të shoqërisë *Bashkimi* (1899). Pastaj kemi periudhat e angazhimeve të Mjedës në shoqërinë *Agimi*, në Konferencën e Ipehkvijve shqiptarë në Shkodër (1-10 maj 1902), atë të triumfit të alfabetit të Mjedës (1902-03), si dhe atë të botimit të parë të serisë së librave shkollorë *Këndime për shkollë të para të Shqipnisë*. Finalja e punës së Mjedës me alfabetin e përbashkët shqip, ka krijuar tre probleme që presin për t'u ndriçuar: Puna e Mjedës për kompromis mes *Bashkimit*, *Agimit* dhe *Stambollit*, ndihmesa e Mjedës në *Kongresin e Manastirit*, si dhe puna e tij për të transkriptuar tekste shkollorë (1910-1914).

B) *Puna e Mjedës për një normë letrare shqiptare.* Kjo fillon me veprimtarinë në *Komisinë Letrare* dhe ekspeditën shken-

core në Elbasan, vazhdon me transkriptimin e autorëve të vjetër dhe mbyllet me ndihmesën e Mjedës në praktikën gjuhësore të revistës *Leka*.

**Mjeda politikan i çështjes kombëtare.** Studimet mjedologjike kanë detyrë që të sqarojnë angazhimet politike të Mjedës, pavarësisht nga mbajtja me nder e veladonit të priftit, apo e staturës së tij prej shkencëtari. Duhet që të sqarohen paradokset e rastit, si dhe zakonet e Mjedës për të protestuar apo për të përgënjeshtuar veten, sa herë u ekspozua me politikë. Mbetet për t'u sqaruar lidhjet që pati indisplinimi i tij në shoqërinë e Jezuitëve për shkak të angazhimeve e aspiratave politike kombëtare, lidhjet mes këtij aspekti dhe daljes nga shoqëria e jezuitëve, si dhe kthimi në atdhe. Duhet sqaruar më tej pjesëmarrja e Mjedës në kryengritjen e mirditorëve e pukjanëve në vitin 1901-02, angazhimi i tij në kryengritjet antiosmane të viteve 1910-12 në luginën e Drinit të Zi, arrestimi i tij nga turqit në tetor 1902, arrestimi i tij nga turqit në nëntor 1912, arrestimi i tij nga serbët në shkurt 1916. Një kapitull i veçantë është edhe ndriçimi i pjesëmarrjes aktive të Dom Ndre Mjedës në Revolucionin e Qershorit 1924, jeta politike e tij aktive në punimet e parlamentit shqiptar në vitet 1921-25 që përfundon me arrestimin nga Zogu në janar-mars 1925.

**Angazhimi i Mjedës për shkollën e arsimin shqip.** Janë përpjekje titanike

të Mjedës që kur ishte student jasht shtetit për të hartuar tekste shkollore, për t'u kthyer në atdhe për të ngritur atje një shkollë shqipe të vërtetë mbi baza moderne. Lidhen me këto plane përpjekjet e Mjedës për të hartuar një *Gramatikë shqipe të krahasuar*, për të hartuar një *Histori të Shqipërisë*, për të bërë gjurmime në arkivat e Vatikanit si dhe në ato të Vjenës, si dhe për të vazhduar korpusin e Coletit e Farlatit, *Illyricum Sacrum*. Këtu përfshihen angazhimet e tij për hapjen e shkollave shqipe, në Vig, në Iballë, në Kryezi, si dhe për hapjen e një gjimnazi shqip. Po ashtu puna e tij si mësues në Vig e në Dajç të Zadrimës. Titanike puna e tij për hartimin e teksteve shkollore shqipe.

**Probleme të metodave të Mjedo-logjisë.** Mbetet që të vihet në themel të metodave krijuese në këtë fushë të shkencës gjurmimet dhe kërkimet e burimeve dokumentare. Ndër metodat theksohet se janë të dobishme sipas rastit qoftë deduksionet qoftë induksionet, gjithmonë duke kujtuar prioritetet që kanë metodat krahasimtare. Vërehet një lloj ngurrimi në përdorimin me guxim të hipotezave shkencore. Duhet përjashtuar paramendimet apo subjektivizmat në shkencë, ardhur në formë atavizmash nga e kaluara jo e largët. Si metoda ndihmëse janë edhe statistika, metoda biografike, anketimi, intervista, transkriptimi, transliterimi, fototipia, arkivistika, etj. Po ashtu lind nevoja e zotërimit të materialeve burimore dhe

administrimi i tyre nga studiuesit e rinj. Kjo lidhet me një lloj impresionimi të studiuesve të rinj nga fetishizimi i burimeve e informacioneve.

#### 4. Botimi i veprës së Mjedës

Botimi i veprës së Mjedës mbetet sot një nga problemet më të mpërhta lidhur ngushtë me studimet mjedologjike. Për shkaqe nga më të ndryshme botimi i veprës së Mjedës është shoqëruar me gabime fatale, të përsëritura në kohë. Këtu përfshihen lapsuset e Mjedës, gabimet e tipografive, e më pas gabimet e botuesve të veprës së Mjedës. Duhet të pranojmë se me përjashtim të Mark Gurakuqit, Dhimitër Shuteriqit, Jup Kastratit dhe Mark Ndojës, botimet e veprës së Mjedës janë bërë nga njerëz inkompetentë, ose të udhëhequr nga qëllime komerciale. Por edhe titullarët që përmendëm më sipër nuk kanë bërë më të mirën e mundshme. Mungesa e dorëshkrimeve ka ndikuar në realizimin e botimeve në nivele amatoreske të veprës së Mjedës. Është neglizhuar botimi i prozës, nën pretekstin se në shumicën e rasteve ajo është prozë hagiografike, ndërsa edhe një botim i veprës gjuhësore të Mjedës u hodh në karton.

Priten botime për kategori të ndryshme të shkollave apo moshave, botime lidhur me veprën e Mjedës për fëmijë. Ndofta në fillim duhet botuar ajo pjesë e letërsisë për fëmijë që është provuar se është e Mjedës, për t'u lënë për më vonë një botim me i plotë, shoqëruar

me studimet e bëra në drejtim të autorësisë së Mjedës. Duhet botuar studimet gjuhësore linguistike të Mjedës. Jam i sigurtë se tani vepra gjuhësore e Mjedës e botuar nga Jup Kastrati është e kapërcyer. Lind nevoja për botimin e kontributeve në fushën e mbledhjes dhe botimit të folklorit shqiptar. Një fushë e rëndësishme është botimi urgjent i *Historisë Shejte* të Mjedës si një nga arritjet më të larta të prozë shqiptare. Po ashtu edhe gjithë letërsisë hagiografike të Mjedës, qoftë edhe të katekizmave e letërsisë tjetër kishitare. Mbeten për t'u bërë botime të zgjedhura të veprës së Mjedës e mbi çdo gjë botimi kritik i saj, ndarë në katër korpuse: poezia, proza, folklori dhe studimet gjuhësore.

### 5. Organizimi dhe nxitja e studimeve mjedologjike

Çfarë mund të bëhet pas shuarjes së brezit të parë, të mjedologëve si Koliqi, Pipa, Camaj, Oroshi, Shwanke, Cordignano, Valentini, Ndue Doçi, Qemal Draçini, Jolanda Kodra, Varfi, Ndocaj, Shuteriqi, Ashta, Prela, Gurakuqi, Bala, Siliqi, Kastrati? Stafetën e studimeve në këtë fushë e ka marrë në dorë një brez i ri, nga më të kualifikuarit, duke filluar me studiuesit elitë Rexhep Qosja, Anton Berisha, Isak Ahmeti, Begzad Baliu, Milazim Krasniqi, Ruzhdi Ushaku, Myr-vete Dreshaj-Baliu, Adil Olluri, Tahir Foniqi, Zenun Gjocaj, Xheladin Zymberi, Hamit Xhaferi, Nebi Caka, Ali Caka, Afrim Rexhepi, Stefan Çapaliku, Skender Drini, Kolec Topalli, Tomor Osmani,

Jorgo Bulo, Koçi Petriti, Rinush Idrizi, Kolec Çefa, Vjollca Osja, Gazmend Krasniqi, Marjana Ymeri. Siç shihet, Prishtina është kthyer tashmë në qëndër graviteti të studimeve mjedologjike.

Duhet menduar për një politikë stimuluese në këtë drejtim, gjë e cila mbetet një fushë për t'u diskutuar herë pas here. Duhet pranuar se në rastin e Mjedës nuk kemi të bëjmë me një temë që pret të shterohet. Ajo mbetet temë e përjetshme, sepse edhe vepra e tij nuk ka mortje. Shqiptarët do të kenë nevojë t'i kthehen e t'i rikthehen veprës së tij, gjithnjë ato do të kenë nevojë të gjejnë zgjidhje të problemeve të veta, qoftë edhe të atyre të ditës tek jeta e vepra e Mjedës. Parashikoj se këto linja nuk do të dobësohen me kalimin e viteve, por do të thellohen e fuqizohen. Vepra e tij mbetet e tillë që do përballojë rrebeshet e kohës. Studimet mbi Mjedën kanë lidhje me vetëdijen letrare si dhe atë kombëtare të shqiptarëve. Mendoj se katër janë linjat që do të kenë për detyrë të nxisin dhe të organizojnë studimet mjedologjike:

1. Institucionet albanologjike, akademitë, arkivat, muzeumet e bibliotekat shqiptare.

2 Universitetet, institucionet pedagogjike-arsimore dhe në përgjithësi shkollat shqiptare.

3. Institucionet e larta shtetërore, si ministria e kulturës, ajo e arsimit, ajo e rinisë.

4. Duhet menduar për krijimin e organizmave speciale, në formë OJQ-sh,



të cilat të kenë mundësi të stimulojnë studimet shkencore mjedologjike. Me interes do të ishte krijimi i një fondacioni Ndre Mjeda, i cili të organizojë studime, kërkime, të japë tituj e grada shkencore, të subvencionojë botimet e veprës së Mjedës apo të studimeve mjedologjike. Të nxisë studiuesit e rinj që kanë nevojë për mbështetje, të japë stimuj, çmime e të akordojë bursa studimi lidhur me Mjedën.

#### 6. Përjetësimi

Mbetet detyrë e studimeve mjedologjike që të sensibilizojnë shoqërinë shqiptare për të gjetur rrugët e duhura për të përjetësuar Mjedën e veprën e tij. Duke filluar me emërtimin e shkollave,

universiteteve, fakulteteve, institutive albanologjike, rrugëve, shesheve, urave, auditoreve me emrin e Ndre Mjedës. Duhet menduar për një pasqyrim të Mjedës në vepra monumentale që të zbukurojnë sheshet tona, ndërtesat e pallatet tona, ndërtesat qeveritare kudo që të jenë. Është e pafalëshme që shqiptarët të neglizhojnë në këtë drejtim, sepse imazhi i Mjedës përbën një nga nivelet përaqësuese kombëtare. Rrethet shkencore-arsimore duhet të organizojnë veprimtari shkencore, si konferenca, simpoziume, po ashtu edhe veprimtari përkujtimore. Ndërsa mediat elektronike dhe shtypi shkencor deri ai periodik, duhet t'i bëjnë jehonë jetës dhe veprës së këtij kolosi të kulturës kombëtare.